AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, TM4 2023

02.02.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e katërt (TM4) 2023.

Rritet indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore në TM4 2023, krahasuar me TM4 2022

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtorale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM4 2020-2023, (2020=100)



Në TM4 2023, indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 9,5%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022. Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 6,5%.

Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 7,5%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Ndryshimi në %, TM4 2023 me TM4 2022

Përshkrimi	TM4 2022	TM4 2023	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	136,9	145,8	6,5
Prodhimet blegtorale	131,1	143,5	9,5
Totali prodhimeve bujqësore	134,9	145,0	7,5

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, për TM4 2023 (2020=100), vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture